



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE
UJËSJELLËS KANALIZIME Durrës SH.A
DREJTORIA E PROKURIMEVE

Durrës më, 18.03.2026

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË
AFATET E ANKIMIMIT

-Drejtuar: B.O.E " ED KONSTRUKSION " sh.p.k. me NIPT K61625001I, me adrese Tirane
Tirane Kryqëzimi i Rrugës "Liman Kaba" me "Prokop Mima", Rezidenca "Olimpik" ,
Shkalla nr. 2, Kati 4, Tiranë, & "ZENIT&CO" sh.p.k me NIPT K61731002D me adrese
Tirane Tirane TIRANE Rruga "Myrteza Topi", Nd.18, Ap.38.

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☒ JO ☐

- **INERTI** shpk me NIPT **J66926804L** me adrese Elbasan Gramsh GRAMSH L. SPORTI.

Tipi i Kontratës: **Pune publike**

Lloji i Procedurës së prokurimit: **E Hapur - punë**

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: **REF-76024-02-12-2026**

Objekti i kontratës /Marrëveshjes Kuadër: **Furnizimi me ujë i zonës së Gjirit të Lalzit”
(Kontratë me çelësa në dorë).**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: **13.02.2026**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletin e Njoftimeve Publike: **Buletini Nr. 14,
datë 16 Shkurt 2026**

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto X
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim ☐

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. “G.A.C” sh.p.k me NIPT L61619031A

Me vlerë të ofruar:

- 59.607.243,00 (Pesëdhjetë e nëntë milion e gjashtëqind e shtatë mijë e dyqind e dyzet e tre) lekë pa TVSH
- 71.348.692,00 (Shtatëdhjetë e një mijë e treqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e dy) lekë me TVSH

Totali i pikëve te marra 0 Skualifikuar

Me Subjekt Mbështetës :

“SHANSI INVEST” shpk me NIPT J61924002T

RAFIN COMPANY shpk me NIPT L52125110A

HTS COMPANY me Nipt M11619018P dhe HE & SK 11 me nipt L19008502B

OE/BOE me nënkontraktor PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____ (Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. B.O.E "ED KONSTRUKSION" sh.p.k. me NIPT K61625001I & “ZENIT&CO” sh.p.k me NIPT K61731002D

Me vlerë të ofruar:

- 62,800,000.00 (Gjashtëdhjetë e dy milion e tetëqind mijë) lekë pa TVSH
- 75,360,000.00 (Shtatëdhjetë e pesë milion e treqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë me TVSH

Totali i pikëve te marra 96.75

Me Subjekt Mbështetës :
INERTI shpk me NIPT J66926804L

OE/BOE me nënkontraktor PO ☐ JO X
Nëse po, të jepen dhënat _____ (Emrat e
nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. “PE-VLA-KU” sh.p.k me NIPT K61716013M

Me vlerë të ofruar:

- 64,348,944.00 (Gjashtëdhjetë e katër milion e treqind e dyzetë e tetë mijë e nëntëqind e dyzetë e katër) lekë pa TVSH
- 76,058,732.80 (Shtatëdhjetë e gjashtë milion e pesëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e tridhjetë e dy) lekë me TVSH

Subjekt Mbështetës :
O.B.KONSTRUKSION shpk me NIPT K93728201A
LEAD CONSULTING SHPK ME NIPT L82322016N

OE/BOE me nënkontraktor PO ☐ JO X
Nëse po, të jepen dhënat _____ (Emrat e
nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Totali i pikëve te marra 91.80

Nga pjesëmarrësit është skualifikuar, Ofertuesi mëposhtëm:

1. “G.A.C” sh.p.k me NIPT L61619031A”

Me vlerë të ofruar:

- 59.607.243,00 (Pesëdhjetë e nëntë milion e gjashtëqind e shtatë mijë e dyqind e dyzet e tre) lekë pa TVSH
- 71.348.692,00 (Shtatëdhjetë e një mijë e treqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e dy) lekë me TVSH

Me Subjekt Mbështetës :

“SHANSI INVEST shpk me NIPT J61924002T

RAFIN COMPANY shpk me NIPT L52125110A

HTS COMPANY me Nipt M11619018P dhe HE & SK 11 me nipt L19008502B

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik për këtë procedurë prokurimi në plotësim të kërkesave të Autoritetit Kontraktor, konstatohet se OE nuk permbush kriteret si më poshtë:

A. OE nuk permbush piken 2.3.5 te kapacitetit Teknik :

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punetore prej minimalisht 47 persona për periudhën, 3 mujore nga momenti i hapjes së ofertave e vertetuar kjo me:

- *Vertetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet*
- *numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën 3 mujore nga momenti i hapjes së ofertave.*

Operatori Ekonomik **“G.A.C” shpk** në lidhje me këtë pikë nuk ka paraqitur fuqi punetore prej minimalisht 47 persona për periudhën, 3 mujore nga momenti i hapjes së ofertave. Referuar Kontrates së anagazhimit dhe shtojcës 8, Formulareve Përmbledhës të Vetedeklarimeve të OE SHANSI INVEST dhe **“G.A.C” shpk** të ngarkuara në SPE, vërehet se OE SHANSI INVEST do të mbështet OE **“G.A.C” shpk** me 27 punonjë nga 47 të kërkuar në pikën 2.3.5, në kundërshtim me pikën 2 paragrafi 4 të nenit 90 të VKM nr 285/2021 Për miratimin e Rregullave të prokurimit Publik, i cili shprehet **“Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor”**.

B. OE nuk permbush piken 2.3.6 te kapacitetit Teknik :

Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë të punësuar stafin teknik të përbërë nga të paktën 25 (njetzetë e pesë) punonjës të specializuar dhe të certifikuar sipas profesionit që kryejnë dhe të pasqyruar në listë pagesat e shoqërisë për periudhën 3 muajt e fundit, duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit, me profesione si më poshtë:

- 2 (dy) teknike ndërtimi
- 1 (një) teknik mekanik
- 2 (dy) karpentier
- 2 (dy) hidroizolues

- 1 (një) betonues
- 5 (pese) hidraulike
- 3 (tre) montator për konstruksione metalike
- 2 (dy) hekurkthyes
- 2 (dy) elektricit
- 2 (dy) shofere për drejtim mjetesh të pajisur me leje drejtimi me kategorine "C" dhe/ose "CE" dhe/ose "D" dhe/ose "DE" leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor.

Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune të vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas Ligjit Nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Për specialistët e mësipërm të paraqiten kartela personale të sigurimit teknik të vlefshme, të lëshuara nga institucione shtetërore ose nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve.

Operatori Ekonomik **"G.A.C" shpk** ne lidhje me kete pike te kapacitetit teknik, si dhe Referuar Kontratave te anagazhimit dhe shtojcave nr.8, OE **"G.A.C" shpk** eshte mbeshtetur nga OE SHANSI INVEST dhe RAFIN KOMPANY, si me poshte.

OE SHANSI INVEST ka rene dakort ta mbeshtesi me :

- 1 Teknik Ndertimi
- 1 Karpertier
- 5 Hidraulike
- 1 montator për konstruksione metalike
- 1 hekurkthyes
- 1 elektricit
- 1 Shofer

Total 11 punonjes te specializuar dhe të certifikuar sipas profesionit

OE RAFIN COMPANY ka rene dakort ta mbeshtesi me :

- 1 Teknik Ndertimi
- 1 Teknik Mekanik
- 2 hidroizolues
- 1 betonues

- 2 montator për konstruksione metalike

Total 7 punonjes te specializuar dhe të certifikuar sipas profesionit

OE G.A.C ka si punonjes te specializur :

- 1 Teknik Ndertimi
- 1 karpentier
- 1 Hidraulik
- 1 betonues
- 1 hekurkthyes
- 2 elektricist

Total 7 punonjes te specializuar dhe të certifikuar sipas profesionit

Nga sa me siper, OE G.A.C nuk e ploteson kete kriter si ne teresi (stafin teknik 25 punonjës), ashtu dhe ne vecanti me (22 punonjes te specializuar dhe të certifikuar sipas profesionit). Ne kundërshtim me piken 2 pragrafi 4 te nenit 90 te VKM nr 285/2021 Per miratimin e Rregullave te prokurimit Publik, i cili shprehet “ **Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor**”.

Gjithashtu eshte konstatuar nje mosperputhje si ne numer ashtu dhe ne emertime referuar shtojces 8 te RAFIN COMPANY dhe Shtojces 8 te OE G.A.C:

- ***OE RAFIN COMPANY ka deklaruar se mbështet OE G.A.C me 7 punonjes te specializuar dhe të certifikuar sipas profesionit:***
 - ***1 Teknik Ndertimi (Ergys Lumani)***
 - ***1 Teknik Mekanik (Arti Mema)***
 - ***2 hidroizolues (Elson Rama + Pelikan Rama)***
 - ***1 betonues (Agron Trimi)***
 - ***2 montator për konstruksione metalike (Bashkim Kola +Arti Mema).***
- ***OE G.A.C ka deklaruar ne shtojcen 8 se do te mbështete nga OE RAFIN KOMPANY me 9 punonjes te specializuar dhe të certifikuar sipas profesionit:***
 - ***1 Teknik Ndertimi (Ergys Lumani)***
 - ***1 Teknik Mekanik (Arti Mema)***

- 2 hidroizolues (Elson Rama + Pelikan Rama)
- 1 betonues (Agron Trimi)
- 2 montator për konstruksione metalike (Bashkim Kola +Arti Mema).
- 1 montator për konstruksione metalike Besnik Dauti
- 1 Ekskavatorist Mustafa Goxhari

Punonjesit Besnik Dauti me specializim montator për konstruksione metalike dhe punonjesi Mustafa Goxhari me specializim Ekskavatorist nuk rezultojne te jene ne shtojcen 8 te RAFIN COMPANY si staf Teknik ne mbeshtetje te OE G.A.C

C. OE nuk permbush piken 2.3.3 te kapacitetit Teknik:

*Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor**, si më poshtë:*

- 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (nje) Inxhinier Elektrik
- 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (nje) Inxhinier Mekanik
- 1 (nje) Inxhinier Mjedisi
- 1 (një) Inxhinier Gjeolog
- 1 (nje) Inxhinier Gjeodet/ Topograf/ Markshnajder

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit 2.3.3 operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Diploma
- CV
- Kontrata e punës

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e personelit kryesor në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces nr.8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Staf Mbeshtetes

1 (Nje) Projektues Arkitekt (Licensa 2 a, d: Projektim arkitekturor për - objekte industriale - objekte turistike, Projektim peizazh, sistemime sipërfaqe të gjelbera, lulishte e parqe.)

1 (Nje) Projektues Konstruktor (Licensa 3 a: Projektim objekte civile – industrial – turistike, prej murature dhe skelet beton arme deri në 5 kate.)

1 (Nje) Projektues Instalator (Licensa 4 a,b,c,j:Projektim të instalimeve hidro-termosanitare, Projektim të instalimeve termoteknike-kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme-Projektim të linjave të rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale-Projektim të sistemeve kundër zjarrit- Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj., për objektet civile e industriale).

Stafi i sipërcituar është staf mbështetës përgatitjen e projektit të zbatimit (Faza I-II).

Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme për projekte të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë sipas përcaktimit në vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”.

Operatori Ekonomik “G.A.C” shpk në lidhje me këtë pikë të kapacitetit teknik nuk përmbush kriterin mbi Stafin Mbështetës pika 2.3.3 :

- pikën 2.3.3 të kapacitetit Teknik, Staf Mbështetës: OE GAC në Shtojcën nr.8 Formulari Përmbledhës i Vetedeklarimit në seksionin B “Informacion mbi subjektin mbi kapacitetin, e të cilave do të mbështetet operatori ekonomik” ka deklaruar si subjekt mbështetës OE HTS COMPANY si dhe HE & SK 11.

Nga verifikimi në SPE rezulton se OE HTS COMPANY dhe OE HE & SK 11 nuk kanë paraqitur shtojcën nr 8 Formularin Përmbledhës të Vetedeklarimit. të dy OE janë persona juridik dhe me NIPT të ndryshëm nga njëri tjetri.

Nga sa më sipër nuk është zbatuar neni 84 i LPP dhe neni 90 i VKM nr 285/2021 Për miratimin e Rregullave të prokurimit Publik. Si dhe Udhëzimi i APP nr 1420 prot date 13.02.2025 drejtuar AK. Ku ndër të tjera shprehet:

OE i cili mvbeshtetet ne kapacitete e nje subjekti tjetër duhet te:

- i. Deklaroj subjektin mbeshtetes.
- ii. Dorezoje nje deklarate me shtj dhe subjektit mbeshtetes ku cilesohet angazhimi I marre ndermjet tyre.
- iii. **Paraqese F.P.V per subjektin mbeshtetes pasi duhet ti provoje AK se nuk ekzistojne shkaqe per skualifikim per perjashtim nga procedura sipas parashikimeve te nenit 76 te LPP-se.**

OE nuk ka permbushur KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES / KUALIFIKIMIT te percaktuara ne shtojcen 7 te DST -ve e cila shprehet:

Këto kriteret duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatoritekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin elartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Gjithashtu konstatohet se nga OE nuk eshte zbatuar pika 2 pragrafi 4 i nenit 90 te VKM nr 285/2021 Per miratimin e Rregullave te prokurimit Publik, i cili shprehet “ Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor”.

Pasi OE G.A.C nuk ka provuar se ploteson 50% të kërkesave të përcaktuara ne STAFIN MBESHTETES, por eshte mbeshtetur plotesisht (100%) tek subjekti mbeshtetes ne kundërshtim me sa me sipër.

Gjithashtu :

Piken 4.4 te DST” Kriteret e përzgjedhjes së fituesit”, OE GAC ne lidhje me kete pike ka paraqitur si afat realizim punimesh afatin prej 90 ditesh, ku nga keto 20 dite duhen per realizimin e projektit. Ne shpjegimin e bere mbi Metodologjine per realizimin e ketij objekti OE ka deklaruar se afati kohor per realizimin e ketij objekti eshte 10 muaj, e cila quhet sfiduese si afat kohor apo edhe 5 muaj ku ne kete afat eshte perfshire edhe periudhen e mobilizimit prej 2 javesh.

Referuar Pikes 4.4 MOBILIZIMI, EKIPET E ANGAZHUARA DHE MAKINERITE tek Metodologjija e punes ngarkuar ne SPE nga OE G.A.C verehen afate kontradiktore,

- a) Ne fillim te ketij kapitulli OE shprehet se “**Programi i punes se Kontraktorit per nje periudhe 10 mujore.**” dhe njehere tjetër po ne kete pike shprehet “**Programi i punes**

mbulon nje periudhe totale prej 5 muajsh". Ne DST pika 2.11 eshte vendosur afati i punimeve 6 muaj sipas grafikut të punimeve nga data e lirit të sheshit,

- b) Per mobilizimin e kantierit OE eshte shprehur " Periudha e mobilizimit prej 2 javesh eshte e nevojshme per te siguruar pergatitjen e duhur per fillimin e sigurt te punes. Me poshte OE shprehet "...Ngritja e kantierit realizohet brenda 20 diteve, duke patur parasysh qe kemi shkuar ne objekt".

Nga sa me siper verehet nje mosperputhje midis grafiut te punimeve dhe metodologjie se punes te paraqitur nga OE G.A.C.

Ne Deklaraten e OE GAC eshte caktuar si Drejtues Teknik i punimeve ne objekt z.Miklovan Alia dhe Z.Ilirjan Sula verehet z.Ilirjan Sula eshte i diplomuar si Inxhinier Hidroteknik.

Kjo bie ndesh me piken nr 2.1 te Udhëzimit Nr.2 datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", I cili shprehet:

2.1 Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar **në inxhinieri ndërtimi**.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **B.O.E " ED KONSTRUKSION " sh.p.k. me NIPT K61625001I, me adrese Tirane Tirane Kryqëzimi i Rrugës "Liman Kaba" me "Prokop Mima", Rezidenca "Olimpik" , Shkalla nr. 2, Kati 4, Tiranë, & "ZENIT&CO" sh.p.k me NIPT K61731002D me adrese Tirane Tirane TIRANE Rruga "Myrteza Topi", Nd.18, Ap.38. me subjekt mbështetës :**

- **INERTI shpk me NIPT J66926804L me adrese Elbasan Gramsh GRAMSH L. SPORTI.** se oferta e paraqitur me vlerë totale PREJ 62,800,000.00 (Gjashtëdhjetë e dy milion e tetëqind mijë) lekë pa TVSH/ totali i pikëve të marra [96.75] është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Ing.Olsen Kavalli